

Vendim nr. 535, datë 29.08.2023 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5 paragrafi 1.1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrativë, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Autoritetit dhe nenit 7, paragrafi 1, paragrafi 2 germa “f” dhe paragrafi 3 të Udhëzuesit “Për rregulla dhe procedura të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 210, datë 30.03.2023, Autoriteti

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të thelluar administrativ me qëllim identifikimin e vendvarrimeve të personave të vdekur ose të zhdukur në Shkodër, si dhe qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur nga Shkodra ose në Shkodër. Objekti i verifikimit përfshin:
 - a) verifikimin e dyshimeve për vendvarrime në Varrezat e Rrmajit, Shkodër;
 - b) verifikimin e dyshimeve për vendvarrime të tjera të dyshuara në Shkodër, mbështetur në të dhëna të paraqitura nga Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë Shkodër dhe të afërm e familjarë të personave të zhdukur;
 - c) qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të shtetasit J.K;
 - c) qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të tjerë të vdekur apo të zhdukur me vendvarrim të dyshuar varrezat e Rrmajit Shkodër;
 - d) verifikimin e thelluar të materialit arkivor të identifikuar në arkivin e Autoritetit, të dhënave, rrethanave dhe fakteve, qartësimin e fatit, si dhe, kur është e mundur identifikimin e vendvarrimeve potenciale dhe/ose identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur apo të zhdukur mbështetur në:
 - i. kërkesat e familjarëve dhe të afërmeve (nr. 174 prot., datë 03.2019; nr. 634 prot., datë 05.2019; nr. 731 prot., datë 07.2020; nr. 1560 prot., datë 09.2022; nr. 468 prot., datë 03.2022; nr. 578 prot., datë 04.2022; nr. 791 prot., datë 05. 2022; nr. 1225 prot., datë 07.2022; nr. 1792 prot., datë 10.2022; nr. 458 prot., datë 03. 2022; nr. 1272 prot., datë 07.2022; me Nr. 1272 prot., dt 26.07.2022; nr. 1225 prot., dt.11.07.2023; Nr. 634 Prot., dt. 08.05.2019);
 - ii. kërkesën nga Arqipeshkvi i Arqipeshvisë Shkodër me nr. 468 prot., datë 28.03.2022;
 - iii. kërkesën dhe të dhënat e paraqitura nga Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë, Shkodër me nr. 417 prot., datë 17.03.2022.
 - dh) përcaktimin e institucioneve bashkëpunimin e të cilave do të kërkojë AIDSSH në procedurën verifikuese me këtë objekt;
 - e) përcaktimin e veprimeve verifikuese, personelit përgjegjës, rezultateve të pritshme dhe afatit të kryerjes së veprimeve verifikuese të procedurës së verifikimit me këtë objekt.

2. Veprimet verifikuese që do të kryhen në funksion të pikës 1 më lart janë:
 - a) Analiza e të dhënave dhe dokumenteve të administruara nga AIDSSH në kuadër të dosjes së krijuar mbi kërkesën e shtetasit H.Z. për vendvarrimin e dyshuar në Varrezat Rrmajt Shkodër dhe eshtrat e të ndjerit J.Z.;
 - b) Analiza e të dhënave, raporteve, procesverbaleve dhe dëshmimeve të mbledhura si rezultat i vizitave dhe kontrolleve në terren dhe komunikimeve me institucione, për rastin e të ndjerit J.Z.;
 - c) Identifikimi i hapave të mëtejshëm verifikues, hartimi i planit të vizitave dhe kontrolleve në terren, komunikimeve, takimeve, marrjes së dëshmimeve nga të afërm a persona me dijeni për ngjarjet për rastin e të ndjerit J.Z., si dhe përpilimi dhe analizimi i raporteve, procesverbaleve dhe dokumentacionit për këtë qëllim;
 - d) Verifikimi paraprak dhe analizimi i të dhënave të mbledhura nga të afërm dhe familjarë përmes formularit të kërkesave për kërkesat e familjarëve dhe të afërmëve me *nr. 174 prot., datë 03.2019; nr. 634 prot., datë 05.2019; nr. 731 prot., datë 07.2020; nr. 1560 prot., datë 09.2022; nr. 468 prot., datë 03.2022; nr. 578 prot., datë 04.2022; nr. 791 prot., datë 05. 2022; nr. 1225 prot., datë 07.2022; nr. 1792 prot., datë 10.2022; nr. 458 prot., datë 03. 2022; nr. 1272 prot., datë 07.2022 me Nr. 1272 prot., dt 26.07.2022; nr. 1225 prot., dt.11.07.2023; Nr. 634 Prot., dt. 08.05.2019*, dokumentacionit nga Arkiva e AIDSSH, si dhe paraqitja e konkluzioneve dhe propozimeve të verifikimit paraprak;
 - e) Identifikimi i veprimeve të mëtejshme verifikuese, komunikimeve institucionale, kërkimit të të dhënave për plotësimin e të dhënave paraprake nga kërkesat e familjarëve dhe të afërmëve me *nr. 174 prot., datë 03.2019; nr. 634 prot., datë 05.2019; nr. 731 prot., datë 07.2020; nr. 1560 prot., datë 09.2022; nr. 468 prot., datë 03.2022; nr. 578 prot., datë 04.2022; nr. 791 prot., datë 05. 2022; nr. 1225 prot., datë 07.2022; nr. 1792 prot., datë 10.2022; nr. 458 prot., datë 03. 2022; nr. 1272 prot., datë 07.2022, me Nr. 1272 prot., dt 26.07.2022; nr. 1225 prot., dt.11.07.2023; Nr. 634 Prot., dt. 08.05.2019*, si dhe analizimi i informacionit dhe dokumentacionit të mbledhur;
 - f) Verifikimi paraprak dhe analizimi i kërkesës nga Arqipeshkvi i Arqipeshkvisë Shkodër me *nr. 468 prot., datë 28.03.2022*, si dhe paraqitja e konkluzioneve dhe propozimeve të verifikimit paraprak;
 - g) Identifikimi i veprimeve të mëtejshme verifikuese, dokumentacionit që do të analizohet, komunikimeve shkresore të nevojshme, si dhe analizimi i informacionit dhe dokumentacionit për kërkesën nga Arqipeshkvi i Arqipeshkvisë Shkodër me *nr. 468 prot., datë 28.03.2022*;
 - h) Analizimi i të dhënave të paraqitura në kërkesën nga Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë, Shkodër me *nr. 417 prot., datë 17.03.2022*, dhe paraqitja e konkluzioneve dhe propozimeve të verifikimit paraprak;
 - i) Identifikimi i veprimeve të mëtejshme verifikuese, dokumentacionit që do të analizohet, komunikimeve shkresore të nevojshme, si dhe analizimi i informacionit dhe dokumentacionit për kërkesën nga Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë, Shkodër me *nr. 417 prot., datë 17.03.2022*.
 - j) Identifikimi i nevojave për dhe gjeografisë së verifikimeve në terren;

- k) Bashkëpunimi me ICMP dhe institucione qendrorë dhe vendore për kryerjen e vlerësimeve arkeologjike dhe antropologjike;
 - a) Administrimi dhe analizimi i raporteve të ekspertimit sipas pikës “k” më lart;
 - b) Komunikimi shkresor me institucione qendrore dhe vendore për qartësimin e dyshimeve për vendvarrime dhe përditësimin e të dhënave të administruara dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur;
 - c) Hartimi i planit të vizitave dhe kontrolleve në terren, komunikimeve, takimeve, marrjes së dëshmive nga të afërm;
 - d) Identifikimi, sipas nevojave, i të afërmeve të personave të zhdukur apo të vdekur dhe komunikimi me ta;
 - e) Mbledhja e deklaratave, dëshmive, dokumenteve nga të afërm dhe familjarë;
 - f) Përgatitja e skicave të vendvarrimeve të dyshuara;
 - g) Krijimi i dosjeve individuale për personat e zhdukur apo të vdekur;
 - h) Përpilimi e raporteve individuale për secilin rast, me të dhënat dhe specifikat e rastit, sipas ecurisë së verifikimeve.
 - i) Paraqitja, rast pas rasti, e propozimeve për masa të ruajtjes së vendvarrimeve, përdorim të metodave jo invazive, gërmime, etj.
 - j) Përpilimin a raporteve periodike mbi mbarëvajtjen dhe rezultatet e veprimtarisë sipas kësaj pike dhe raportimin e tyre përpara Autoritetit;
 - k) Përpilimin e një raporti përfundimtar me analizën e të dhënave të mbledhura dhe rezultateve të arritura në përfundim të procedurës verifikuese në tërësi.
3. Kryerja e procedurës së verifikimit kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë institucionale me institucionet dhe/ose organizata dhe/ose persona fizikë a juridikë si vijon:
- a) Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi;
 - b) Rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë;
 - c) ICMP;
 - d) Kishën Katolike;
 - e) Bashkinë Shkodër;
 - f) Institutin e Mjekësisë ligjore;
 - g) Policinë Shkencore.
4. Veprime të tjera verifikuese, në varësi të ecurisë së procedurës së verifikimit dhe rast pas rasti, përcaktohen me Urdhër të Kryetares.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni